



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:232534

Datë: 02.02.2024

Numri i dokumentit: 05276800

**C.nr.3552/2023**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i përgjithshëm, Divizioni Civil**, gjyqtari Taulant Rexhëbeqaj, në çështjen juridike kontestimore të paditësve Sh.M.1., me nr. personal: ..... nga Prizreni, Sh.M.2., me nr.personal të ..... me vendbanim ne Prizren, V.H.F. me nr. personal ..... nga Prizreni, V.K.1., me numër personal ..... nga fshati .... komuna e Prizrenit dhe V.K.2., me nr. personal .... nga fshati .... komuna e Prizrenit, të cilat me autorizim i përfaqëson av. A.H. nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, në Prizren, të cilën me autorizim e përfaqëson, përfaqësuesja ligjore e Komunës V.I.Xh. me objekt të padisë kompensimi i shujtave, vlera e kontestit 1,578.00 (njëmijë e pesëqind e shtatëdhjetë e tetë) euro, jashtë shqyrtimit gjyqësor, me datë **02.02.2024**, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**Pa shqyrtim kryesor të çështjes**

- I. APROVOHET** kërkesëpadia e paditësve Sh.M.1., Sh.M.2., V.H.F., V.K.1., dhe V.K.2., në tërësi **si e bazuar**.
- II. DETYROHET** e paditura, Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, në Prizren, që paditësve, ti paguaj shumat si në vijim:
- a) Paditësit Sh.M.1., në emër të shujtave ditore, për 120 ditë pune (nga dt.01.01.2022 deri më 20.11.2022), të paguaj shumën prej nga 2 (dy) euro, apo **shumën e përgjithshme prej 240.00 (dyqind e katërdhjetë ) euro**,
- b) Paditësit Sh.M.2., në emër të shujtave ditore, për 120 ditë pune (nga dt.01.01.2022 deri më 20.11.2022), të paguaj shumën prej nga 2 (dy) euro, apo **shumën e përgjithshme prej 240.00 (dyqind e katërdhjetë ) euro**,
- c) Paditëses V.H.F. në emër të shujtave ditore, për 60 ditë pune (nga dt.01.01.2022 deri më 20.11.2022), të paguaj shumën prej nga 2 (dy) euro, apo **shumën e përgjithshme prej 120.00 (njëqind e njëzet ) euro**,
- d) Paditësit V.K.1., në emër të shujtave ditore, për 252 ditë pune (nga dt.01.01.2020 deri më 31.12.2020 dhe nga data 01.01.2022 deri më datë 20.11.2022), të paguaj shumën prej nga 2 (dy) euro, apo **shumën e përgjithshme prej 504.00 (pesëqind e katër) euro**,
- e) Paditëses V.K.2., në emër të shujtave ditore, për 237 ditë pune (nga dt.01.01.2020 deri më 31.12.2020 dhe nga data 01.01.2022 deri më datë 20.11.2022), të paguaj shumën prej nga 2 (dy) euro, apo **shumën e përgjithshme prej 474.00 (katërqind e shtatëdhjetë e katër) euro**,

Shuma e përgjithshme të cilën është e detyruar e paditura Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, në Prizren, që t'ia paguaj paditësve Sh.M.1., Sh.M.2., V.H.F., V.K.1., dhe V.K.2., në emër të kompensimit të shujtave ditore, të cekura në pikë a), b), c), d) dhe e) të këtij dispozitivi është **1,578.00 (njëmijë e pesëqind e shtatëdhjetë e tetë) euro**, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë 31.10.2023, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

**III. DETYROHET** e paditura që paditësve t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej **342 (treqind e katërdhjetë e dy) euro**, në afat prej 7 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm

### A r s y e t i m

Paditësit Sh.M.1., Sh.M.2., V.H.F., V.K.1., dhe V.K.2., përmes të autorizuarit të tyre av. A.H. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate, me dt.31.10.2023, kanë parashtruar padi, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt të padisë kompensimi i shujtave ditore, vlera e kontestit 1,578.00 (njëmijë e pesëqind e shtatëdhjetë e tetë) euro.

I autorizuari i paditësve, në padi ka theksuar se paditësit Sh.M.1., Sh.M.2., V.H.F., V.K.1., dhe V.K.2., punojnë si mësimdhënëse në SHMLM "Lorenc Antoni" në Prizren, në kuadër të Drejtorisë Komunale të Arsimit. E paditura nuk u ka përmbush detyrimin për pagesën e shujtave sipas vërtetimeve për ditë e pranisë në punë. Andaj, ka propozuar gjykatës ta aprovojë në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësve me kamatë ligjore prej 8% nga dita e paraqitjes së padisë. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura, përmes të autorizuarës të saj, në përgjigjen në padi e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve, lidhur me kompensimin nga marrëdhënia e punës. Ka theksuar se përfitues të beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm antarët e Sindikatës së Arsimit – SBASHK, ndërsa paditësit nuk kanë ofruar ndonjë provë që janë anëtar të sindikatës. Po ashtu ka theksuar se të paditurës nga ana e Ministrisë së Financave nuk i është ndarë kod buxhetor për përmbushjen e obligimeve që dalin nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017 dhe 22.01.2021, andaj e njëjta nuk ka mundësi ligjore për të përmbushur këtë obligim, pasi që bie në kundërshtim me Ligjin për Buxhetin Nr.08/L-193. Gjithashtu e paditura ka theksuar se padia e paditësve është në kundërshtim me nenin 90 par.1.1 dhe 1.2 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, pasi sipas këtyre dispozitave marrëveshja kolektive lidhet mes organizatës së punëdhënësit dhe organizatës së të punësuarve, ndërsa në këtë rast Komuna e Prizrenit është punëdhënësi dhe nuk mund të obligohet në përmbushjen e kësaj kontrate, pa qenë pale nënshkruese e saj.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 152 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditësve është e bazuar, andaj pa shqyrtim të çështjes, e aprovoi kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Mes palëve nuk rezulton të jetë kontestues fakti se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura, përkatësisht mësimdhënës pranë në SHMLM “Lorenc Antoni” në Prizren.

Gjykata përmes vërtetimit me nr të references 145/41/2023, të dt.20.09.2023, të lëshuara nga ana e drejtorit të SHMLM “Lorenc Antoni” në Prizren, vërtetoi faktin se paditësi Sh.M.1., gjatë vitit 2022, respektivisht nga data 01.01.2022 deri më datë 20.11.2022 ka punuar 120 ditë pune.

Gjykata përmes vërtetimit me nr të references 145/42/2023, të dt.20.09.2023, të lëshuara nga ana e drejtorit të SHMLM “Lorenc Antoni” në Prizren, vërtetoi faktin se paditësi Sh.M.2., gjatë vitit 2022, respektivisht nga data 01.01.2022 deri më datë 20.11.2022 ka punuar 120 ditë pune.

Gjykata përmes vërtetimit me nr të references 145/48/2023, të dt.20.09.2023, të lëshuara nga ana e drejtorit të SHMLM “Lorenc Antoni” në Prizren, vërtetoi faktin se paditësja V.H.F. gjatë vitit 2022, respektivisht nga data 01.01.2022 deri më datë 20.11.2022 ka punuar 60 ditë pune.

Gjykata përmes vërtetimit me nr të references 09-7/2021, të dt.18.01.2021, të lëshuara nga ana e drejtorit të SHMLM “Lorenc Antoni” në Prizren, vërtetoi faktin se paditësi V.K.1., gjatë vitit 2020, respektivisht nga data 01.01.2020 deri më datë 31.12.2020 ka punuar 117 ditë pune, ndërsa përmes vërtetimit me nr të references 145/45/2023, të dt.20.09.2023, të lëshuara nga ana e drejtorit të SHMLM “Lorenc Antoni” në Prizren, vërtetoi faktin se paditësi V.K.1., gjatë vitit 2022, respektivisht nga data 01.01.2022 deri më datë 20.11.2022 ka punuar 135 ditë pune pra gjithsej ditë punë për periudhën 01.01.2020 deri më datë 31.12.2020 dhe 01.01.2022 deri më datë 20.11.2022 ka 252 ditë pune .

Gjykata përmes vërtetimit me nr të references 09-8/2021, të dt.18.01.2021, të lëshuara nga ana e drejtorit të SHMLM “Lorenc Antoni” në Prizren, vërtetoi faktin se paditësja V.K.2., gjatë vitit 2020, respektivisht nga data 01.01.2020 deri më datë 31.12.2020 ka punuar 117 ditë pune, ndërsa përmes vërtetimit me nr të references 145/46/2023, të dt.20.09.2023, të lëshuara nga ana e drejtorit të SHMLM “Lorenc Antoni” në Prizren, vërtetoi faktin se paditësja V.K.2., gjatë vitit 2022, respektivisht nga data 01.01.2022 deri më datë 20.11.2022 ka punuar 120 ditë pune pra gjithsej ditë punë për periudhën 01.01.2020 deri më datë 31.12.2020 dhe 01.01.2022 deri më datë 20.11.2022 ka 237 ditë pune

Vërtetimet e lartcekura, Gjykata i pranoi si provë materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par.1, të LPK-së, në të cilin paragraf përcaktohet se “*Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të*”. Andaj pasi këto vërtetime janë lëshuar nga vet e paditura brenda fushëveprimit të saj, ashtu që vërtetimeve të SHMLM “Lorenc Antoni” në Prizren, gjykata i’a fali besimin e plotë, si provë me të cilën vërtetohet fakti lidhur me ditët e punës gjatë vitit 2021, konkretisht paditësit Sh.M.1., ka punuar 120 ditë pune, Sh.M.2., ka punuar 120 ditë pune, V.H.F. ka punuar 60 ditë pune, V.K.1., ka punuar 252 ditë pune dhe V.K.2., ka punuar 237 ditë pune.

Bazuar në faktet e çështjes, Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, me nr.01/B, nr. prot. 105, e dt.22.01.2021, të

nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 22.01.2021.

Sipas neni 35 par.7, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, me nr.01/B, nr. prot. 105, e dt.22.01.2021, *“Të punësuarve (antarë të SBAShK-ut), u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimeve të ushqimit në punë, për një ditë pune, është dy euro për të punësuarit të cilët kanë marrëdhënie pune primare në institucionet arsimore...”*.

Në rastin konkret gjykata gjeti se e paditura ka pasur për detyrim që paditësve si punëtorë të arsimit t’ia paguaj kompensimin për shujtat ditore, konform detyrimeve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive, e në kuptim të Nenit 55 par.1 dhe 2 të Ligjit të Punës. Rrjedhimisht lidhur me kompensimin e shujtave ditore për paditësit, Sh.M.1., ka punuar 120 ditë pune, dhe të njëjtit i takon shuma prej 240 euro; Sh.M.2., ka punuar 120 ditë pune, dhe të njëjtit i takon shuma prej 240 euro; V.H.F. ka punuar 60 ditë pune dhe të njëjtës i takon shuma prej 120 euro; V.K.1., ka punuar 252 ditë pune dhe të njëjtit i takon shuma prej 504 euro dhe V.K.2., ka punuar 237 ditë pune dhe të njëjtës i takon shuma prej 474.00 euro, apo shuma e përgjithshme **1,578.00 (njëmijë e pesëqind e tridhjetë e tetë) euro**. Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke u bazuar në nenin 35 par.7, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, me nr.01/B, nr. prot. 105, e dt.22.01.2021, pasi që për paditësit kërkesa për kompensimin e shujtave ditore është bërë e arritshme.

Gjykata me rastin e vendosjes, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 152 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton: *“Po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim (neni 143 dhe 147 të këtij ligji), nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij.”*.

Andaj, bazuar në dispozitat e nenit 152 të LPK-së, Gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe atë pa caktuar seancë gjyqësore, pasi që vlerësoi se në rastin konkret, kërkesëpadija e paditësve është qartazi e themeltë pasi që bazohet në dispozitat e të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, me nr.01/B, nr. prot. 105, e dt.22.01.2021, ndërsa shuma e kompensimit vërtetohet nga provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Sa i përket kundërshtimeve të paditurës me përgjigj në padi, Gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara mbi dispozitat ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike, ndërsa çështja e mënyrës së pagesës, respektivisht mundësisë së pagesës nga ana e të paditurës nuk është rrethanë e natyrës juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritor.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë (31.10.2023), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditura është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Vendimin që pala e paditur ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449, 452, 453.2 dhe 463 të LPK-së, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, lartësia e shpenzimeve i referohet përpilimit të padisë në shumën prej 312 euro dhe taksës gjyqësore në shumën prej 30 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 348.00 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 152 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**Departamenti i Përgjithshëm**  
**C.nr.3352/2023, date 02.02.2024**

**G j y q t a r i**

**Taulant Rexhëbeqaj**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve, pas pranimit të tij, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën